




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova  
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo

<b>DATË/A:</b>	26.03.2020
<b>REFERENC-Ë:</b>	28/03/2020
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Vjosa Osmani, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës
<b>CC:</b>	Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis të Kuvendit të Republikës së Kosovës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Bislim Zogaj / Drejtor i AMKMK-së 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Raporti Vjetor i AMKMK-së për vitin 2019</b>

E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit të Kosovës,

Përmes kësaj shkrese iu dërgojmë Raportin Vjetor të AMKMK-së për vitin 2019.

Bashkëngjitur me këtë Raport Vjetor do të keni:

- Raportin Financiar të AMKMK-së për vitin 2019;
- Planin e punës së AMKMK-së për vitin 2020.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova  
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo

**AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE  
TË KOSOVËS**

Raporti Vjetor i Punës së AMKMK-së për vitin 2019

## Përmbajtja

<b>1. Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	5
<b>2. Korniza Ligjore</b> .....	6
<b>3. Fushëveprimi i Agjencisë</b> .....	7
<b>4. Organizimi i Agjencisë</b> .....	8
4.1. Organogrami i AMKMK-së .....	9
4.2. Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2019.....	10
4.3. Asetet që ka në disponim AMKMK .....	10
4.4. Hapësira për punë .....	10
<b>5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese 2019</b> .....	11
5.1. Aktivitetet kryesore të ekzekutuara gjatë vitit 2019 janë këto .....	11
5.1.1. Departamenti për financa dhe shërbime të përgjithshme .....	11
5.1.2. Departamenti për planifikim, projekteve dhe menaxhim .....	12
5.1.3. Divizioni i Prokurimi .....	12
5.1.3.1. Procedurat për furnizim .....	12
5.1.3.2. Procedurat për shërbime .....	12
5.1.3.3. Procedurat për punë .....	13
5.1.3.4. Procedurat e projektimit .....	14
5.2. Divizioni për burime njerëzore .....	15
<b>6. Përmirësimet dhe monitorimi i fushës së veprimit</b> .....	16
<b>7. Planet që parashikohen për vitin – 2020</b> .....	17
7.1. Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.....	17
7.2. Departamenti për Planifikim ,Projekte dhe Menaxhim .....	17
7.3. Divizioni i Prokurimit.....	17
7.3.1. Procedurat për furnizim .....	17
7.3.2. Procedurat për shërbime .....	17
7.3.3. Procedurat për punë .....	18
7.3.4. Procedurat e projektimit .....	20
7.4. Divizioni i Burimeve Njerëzore.....	20

<b>8. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit).....</b>	<b>22</b>
<b>9. Raporti Financiar .....</b>	<b>24</b>
<b>10. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm .....</b>	<b>26</b>
<b>9.Shtojcat nr 9 .....</b>	<b>28</b>
<b>10. Shtojca Nr. 1. Asetet që posedon AMKMK-ja.....</b>	<b>29</b>
<b>11. Shtojca Nr.2. Plani i aseteve për vitin 2020 .....</b>	<b>42</b>

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK), është institucion i pavarur, që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Kjo Agjenci është themeluar në vitin 2013, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së, dhe pas publikimit në Gazetën zyrtare GZK/Nr.9/ më datë 26.04.2013.

Agjencia për punën e vet i raporton një herë në vit komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis, të Kuvendit të Republikës së Kosovës (KBPZHRIM). Rrjedhimisht, AMKMK do të paraqesë raportin vjetor përkitazi me të gjitha aktivitetet lidhur me zbatimin e Ligjit të AMKMK-së.

Kështu, në këtë raport do të paraqiten arritjet e agjencisë për vitin 2019 si dhe objektivat dhe sfidat për vitin 2020.

Arritjet e AMKMK-së për vitin 2019 janë: realizimi i projekteve sipas Ligjit të Buxhetit të vitit 2019, ekzekutimi i planit të prokurimit, zbatimi i planit të personelit dhe përmbushja e bazës ligjore.

Në krahasim me vitin 2018 ka pasur një rritje simbolike të buxhetit, me ç'rast është rritur edhe numri i projekteve kapitale.

Ndërkaq, objektivat e parashikuara nga agjencia për vitin 2020 janë:

- Realizimi i buxhetit sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2020;
- Implementimi i planit të prokurimit dhe personelit;
- Hartimi i projekt strategjisë dhe planit të veprimit të AMKMK-së;
- Realizimi i shpronësimit të pronave ku gjenden komplekset memoriale, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Transfereve dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Zgjerimi i rrjetit të mirëmbajtjes së të gjitha memorialeve në Kosovë.

Kurse, sfidat kryesore për vitin 2020, dhe jo vetëm, do të jenë:

- Zgjidhja e qeshtjes pronësore juridike e pronave në komplekse dhe memoriale;
- Rritja e buxhetit të AMKMK-së;
- Rritja e stafit profesional dhe
- Bashkëpunimi ndërinstitucional.

## 2. Korniza Ligjore

Baza ekzistuese ligjore që e rregullon fushë-veprimtarinë e Agjencisë është Ligji Nr.04/L-146 për AMKMK-në (GZK) Nr.9/ datë 26.04.2013, që deri më tani nuk ka pasur ndonjë ndryshim, plotësim dhe as vështirësi në zbatim të Ligjit.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës funksionon në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Agjencia ka nxjerrë Rregulloren e Brendshme Nr.01/2019 për Sistematizimin e vendeve të punës në AMKMK.

Në këtë Agjenci janë nxjerrë Aktet nënligjore në pajtim me Ligjin Nr.04/-146 të AMKMK-së.

- Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014 për Stemen e Agjencisë së AMKMK-së;
- Rregullore Nr.04/2014 për caktimin e shpenzimeve të telefonave mobil dhe fiks të AMKMK-së;
- Rregullorja Nr.05/2016 për punët në Teren, punët Shtesë;
- Rregullorja Nr.06/2017 për Krijimin e të Hyrave.

Pas aprovimit të Ligjit Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz-GZK Nr.19, ka filluar procedura e nxjerrjes së vendimeve dhe akteve nënligjore. Sipas Ligjit në fuqi, me propozim të Agjencisë, vendimet dhe akti nënligjor miratohet në Qeveri.

Në procedurë të hartimit në AMKMK është Projekt Rregullorja për Mënyrën e Sjelljes së Vizitorëve në Hapësirat e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

### 3. Fushëveprimi i Agjencisë

Agjencia është organ i pavarur për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

Agjencia është person juridik dhe për punën e vet i raporton me shkrim një herë në vit deri më 31 mars, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Agjencia e ka stemën e cila përkufizohet me akt nënligjor.

Agjencia është përgjegjëse për:

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- Përcaktimin i programeve kërkimore - shkencore, aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- Bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitatet përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- Krijimin e Web-Faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikimin e revistën vjetore;
- Inicimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitjen e propozimit për miratim në Kuvend;
- Hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- Hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- Propozon shpalljen e zonave me interes të veçantë kombëtar dhe me karakter historik.

**Vizioni i AMKMK-së** është realizimi i kompetencave sipas ligjit në fuqi, ndërtimi, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe promovimi i Komplekseve dhe Memorialeve, të cilat përfaqësojnë të kaluarën e lavdishme të historisë së Kosovës.

**Misioni i AMKMK-së:** Misioni i AMKMK-së është rritja e buxhetit në vitet në vazhdim, rritja e stafit të punëtorëve profesional, mirëmbajtja e komplekseve memoriale.

#### 4. Organizimi i Agjencisë

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në strukturën organizative nuk ka Bord, për shkak se nuk është paraparë sipas Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së.

Organi më i lartë ekzekutiv në agjenci është Drejtori. Pra, Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i Agjencisë, i cili është përgjegjës për: administrimin dhe menaxhimin e Agjencisë, organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që u përjasin funksioneve të Agjencisë. Poashtu, bën menaxhimin efektiv të resurseve që i janë besuar Agjencisë, menaxhimin e buxhetit të Agjencisë dhe mënyrën e shpenzimit të tij, përfaqësimin e Agjencisë brenda dhe jashtë vendit, lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare në pajtim me ligjet në fuqi, si dhe angazhimin e ekspertëve jashtë Agjencisë.


Ndërkaq, AMKMK sipas organogramit ka dy Departamente:

- Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili në përbërje të vetë ka këto divizione: Divizionin për Buxhet dhe Financa, Divizionin Ligjor, Divizionin për Teknologji informative, GIS dhe Shërbime të Logjistikës, dhe
- Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim, i cili ka në përbërjen e vetë këto divizione: Divizioni për Planifikim dhe Projekte të Komplekseve dhe Divizioni për Menaxhim të Projekteve. Ky departament ende nuk është funksionalizuar në tërësi për shkak të mungesës së stafit.

Nëpunësit e Agjencisë kanë statusin e shërbyesve civil.



#### 4.1. Organogrami i AMKMK-së



#### 4.2 Numri i të Punësuarve në AMKMK -2019

Në AMKMK janë të punësuar njëzet e një (21) nëpunës në këto kategori funksionale:

Tabela 1. Numri i të punësuarve në AMKMK

Nr.	Kategoritë funksionale	Numri i të punësuarve
1.	Niveli i lartë drejtues	1
2.	Niveli drejtues	6
3.	Niveli profesional	11
4.	Niveli tekniko administrativ	3

#### 4.3 Asetet që ka në disponim AMKMK

Asetet janë të regjistruara në sistemin SIMFK të Departamentit të Thesarit, sipas Rregullores MF – Nr. 02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore.

Tabela 2. Asetet e AMKMK-së

Nr.	Klasifikimi i pasurive	Vlera
1.	Pajisje	63,649.66
2.	Automjetet	19,038.10
3.	Ndërtimi i Komplekseve Memoriale	12,021,468.86
<b>Gjithësej:</b>		<b>12,104,156.62</b>

AMKMK-ja, sipas ligjit obligohet të menaxhojë me të gjitha asetet e veta në Komplekset Memoriale të Kosovës, përkatësisht investimet kapitale të bëra në këto Memoriale.

Këtij raporti i janë bashkangjitur asetet në detaje si shtojcë në pikën 9 (Shtojca1).

#### 4.4 Hapësira për punë:

Zyret e AMKMK-së janë të vendosura në ndërtesën e objektit të ish- Gjykatës Themelore, me adresë: Rr. Zenel Salihu pn, 10000 Prishtinë. Me numrin e tanishëm të punëtorëve kemi hapësirë të mjaftueshme. Mirëpo, duke pasë parasysh kërkesat e vazhdueshme të këtij institucioni për punëtorë të rinj, me rritjen e stafit do të jetë e nevojshme të rritet edhe hapësira fizike.

## 5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese

AMKMK gjatë vitit 2019 ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh, si: Ekzekutimi i punimeve të Komplekseve dhe Memorialeve sipas Ligjit të Agjencisë Nr.04/L-146 ku një pjesë e ndërtimeve të Memorialeve janë ekzekutuar, ndërsa pjesa tjetër pritet të ekzekutohen viteve në vijim. Në krahasim me vitet e kaluara në vitin 2019 ka pasur një rritje të buxhetit në investime kapitale dhe si rrjedhojë janë rritur numri i projekteve.

Duke pasë parasysh përbërjen e Agjencisë, aktivitetet e implementuara për vitin raportues do të ndahen në bazë të departamenteve.

Tabela 3. Krahasimi përgjatë tri viteve të fundit

Krahsimi përgjatë tri viteve të fundit			
	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Buxheti	3,911,878.00	5,246,216.00	6,933,973.00
Numri i projekteve	19	27	50
Mirëmbajtja	4	7	16
Personeli	12	12	21

\* Sqarim: Me ligjin për buxhet të vitit 2019 kanë qenë të ndara 6,933,973.00, prej të cilave 3,000,000.00 kanë qenë të ndara vetëm për Komplexin Memorial “Adem Jashari“, duke llogaritur se do filloi projekti për konservimin e “Shtëpive të Rezistencës”. Pasiqë ky projekt nuk është realizuar nga këto mjete (2,922,009.10) i janë kthyer buxhetit të Kosovës.

### 5.1. Aktivitetet kryesore të ekzekutuara gjatë vitit 2019 janë këto

#### 5.1.1. Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

- Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2019, 92% e buxhetit është shpenzuar.
- Planifikimi buxhetor për vitin 2020 sipas Qarkoreve Buxhetore të MFT.
- Marrveshje bashkëpunimi me organe të ndryshme komunale dhe qendore;
- Realizimi i shërbimeve të logjistikës;
- Mirëmbajtja dhe administrim i sistemit të Agjencisë (Interneti, telefoni, Web Faqja, Fan page)
- Mbeshtetja teknike për nevojat e stafit të Agjencisë;
- Shërbimet e IT për nevojat e Agjencisë;
- Menaxhimi i nevojave të transportit të Agjencisë;
- Nxjerrja e dy projekt rregulloreve ligjore;
- Bashkëpunimi me organet komunale në krijimin e bazës së të dhënave për memorialet dhe komplekset në gjithë territorin e Kosovës (Kjo nuk është arritur plotësisht prandaj është propozuar të realizohet sistemit GIS për këtë vit).

### **5.1.2. Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim**

- Hartimi dhe projektimi i projekteve;
- Menaxhimi i projekteve kapitale;
- Mbikqyrja në terren e projekteve;
- Analizimi dhe vlerësimi i projekteve të ndryshme;
- Pranimi teknik i projekteve

### **5.1.3. Divizioni i Prokurimi:**

- Ekzekutimi i planit të prokurimit për vitin 2019
- Planifikimi i prokurimit për vitin 2020

Procedurat e prokurimit që janë zhvilluar për vitin 2019  
AMKMK gjatë periudhës së vitit 2019 ka zhvilluar një sërë të aktiviteteve, këto janë:

- Procedurat për furnizim;
- Procedurat për shërbime;
- Procedurat për punë;
- Procedurat e projektimit.

Në vazhdim do t'i përshkruajmë në detaje të gjitha këto aktivitete.

#### **5.1.3.1. Procedurat për furnizim**

- Sistemi për menaxhimin e mirëmbajtjes së flamujve dhe shtyllave, furnizimi me flamuj dhe shtylla si dhe vendosja e tyre në Komplekset Memoriale.
- Furnizim me pajisje të teknologjisë informative dhe material zyrtarë në AMKMK.
- Furnizim me inventar për zyrat e AMKMK-së.
- Furnizim me klima për nevojat e AMKMK-së.
- Furnizim me kimikë, fletore, kalendar (artikujt të jenë me llogo të AMKMK-së) për nevojat e AMKMK-së.

#### **5.1.3.2. Procedurat për shërbime**

- Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit për Ndërtimin e Kompleksit Memorial "Obelisku i Fëmijëve të Martirizuar të Kosovës në Aeroportin e Prishtinës".
- Mirëmbajtja e KM- Dyz dhe Kaqandoll - Podujevë.
- Mirëmbajtja e KM- Kulla e Zahir Pajazitit -Orllan, Podujevë.
- Ruajtja dhe Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në Kompleksin Memorial në Marinë - Skenderaj.
- Mirëmbajtja e K M - Masakra e Familjes Ahmeti, Likoshan - Drenas.

- Hartimi i Projektit të Konservimit dhe Restaurimit të Objekteve” “Shtabi i UÇK-së në Kosterc - Skenderaj” dhe “Memorialin Masakra në Poklek të Vjetër-Drenas.
- Mirëmbajtja e K M “Dëshmorët e Kombit, Vrellë- Istog.
- Mbikëqyrja Profesionale e Punimeve në Ndërtimi i Fazës së Parë Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, ZOD -Glllogjan, Deçan - Anuluar.
- “Hartimi i Projektit Kryesor për Ndërtimin e Varrezave të Martirëve dhe Pllaka Përkujtimore në Çikatovë e Vjetër - Drenas”.
- Mirëmbajtja e K M “Masakra e Raçakut”, Raçak- Shtime.
- “Hartimi i Projektit Kryesor për Ndërtimin e Lapidarit të Masakrës së Burgut të Dubravës - Istog”.
- “Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit për “Konservimin e Shtabit të UÇK-së në Kosterc -Skënderaj”.
- “Mirëmbajtja e Memorialëve dhe Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në Komunën e Skënderajt – Anuluar.

### 5.1.3.3. Procedurat për punë:

Gjatë vitit 2019 AMKMK-ja ka zhvilluar një sërë aktivitetesh të cilat kanë rezultuar me ndërtimin e disa komplekseve memoriale në tërë territorin e Kosovës të cilat menaxhohen nga AMKMK-ja. Krahasuar me vitet paraprake, themi se është rritur numri i komplekseve memoriale që janë ndërtuar dhe që do të ndërtohen në vazhdim (projektet 2 dhe tri vjeçare).

- Ndërtimi i Memorialit “Masakra e Familjes Deliu dhe Mulliqi”, Abri e Epërme – Drenas.
- Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorëve, Prigodë - Istog.
- Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së- Malishevë.
- Sanimi i Dëmtimeve në Lapidarin e UÇK-së, Komoran dhe Lapidarit të Rasim Kiçina e Ragip Halilaj – Negrovç, Drenas.
- Punët Shtesë në Ekzekutimin e Punëve në Rregullimi i Parkingut të Varrezave të Dëshmorëve, Negrovç-Drenas.
- Konservimi dhe Ndërtimi i Kompleksit Memorial - Historik - Shtabi i ZOD-it të UÇK-së në Glllogjan (Faza I, vazhdon në viti 2020).
- Rregullimi i Komplekseve dhe Memorialeve të Dëshmorëve dhe Martirëve në Fshatrat e Komunës së Skënderajt.
- Ndërtimi i Memorialit të Familjes Berisha, Suharekë - Faza e -II-të.
- “Ndërtimi i Parkut Përkujtimorë, Jabllanicë e Vogël – Pejë”.
- Ndërtimi i Memorialit të UÇK-së në Viti dhe Derdhja në Bronz e Dy Busteve.
- Ndërtimi i Monumentit “Në Nderim të Lëvizjes - Nënata e Zhupës” Rajoni

- i Zhupës – Prizren. (Nuk është realizuar për shkak të qështjeve pronësore juridike)
- “Sanimi i Dëmtimeve të Urës së Drurit në K M “Adem Jashari” Prekaz”.
- Riparimi i Varrezave të Dëshmorëve dhe Martirëve në Qyshk të Pejës.
- Ndërtimi i Varrezave të Martirëve dhe Pllaka Përkujtimore në Çikatovë e Vjetër - Drenas.
- Ndërtimi i Varrezave të Dëshmorëve si dhe Restaurimi dhe Konservimi i Shtabit të UÇK-së në Kostërc, Skenderaj.
- Ndërtimi i Memorialit të Martirëve – Studime, Vushtrri (vazhdon në vitin 2020).
- Ekzekutimi i Punëve në KM “Dëshmorët e UÇK-së” Jabllanicë, Gjakovë (vazhdon në vitin 2020)
- Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së, Gramaqel dhe Carrabreg i Epërm – Deçan (vazhdon në vitin 2020).
- Punët Shtesë në Ekzekutimi i Punëve në Rregullimin e Komplekseve dhe Memorialeve të Dëshmorëve dhe Martirëve në Fshatrat e Komunës së Skënderajt.
- Punët shtesë në Ekzekutimi i fazës së -III-të në K.M. “27 Prilli” Mejë-Gjakovë.
- Punët Shtesë në Ekzekutimi i Punëve në “Ndërtimi (vazhdimi) i fazës së tretë të K.M. “Beteja e Koshares”- Koshare.
- Punët Shtesë në Ekzekutimi i Punëve në Restaurimin dhe Konservimin e Objekteve Brenda ZIV “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë - Malet e Berishës, Faza e -II-të (vazhdon në vitin 2020).
- Ndërtimi (asfaltimi) i Rrugicave në KM “Adem Jashari Prekaz”-Skenderaj (i anuluar).
- Ndërtimi i Memorialit “Masakra e Familjes Deliu dhe Mulliqi” Abri e Epërme - Drenas - Faza e –II.
- Rindërtimi i Lapidarit “Zahir Pajaziti” Pestovë – Vushtrri.
- “Ngritja e Pllakës Përkujtimore për Daljen e Parë Publike të UÇK-së në Llaushë të Skënderajt ”. (e anuluar për shkaqe pronësore juridike).
- Punët shtesë “Ndërtimi i Memorialit të UÇK-së në Viti dhe Derdhja në Bronz e Dy Busteve”.
- “Ndërtimin e Memorialit të Masakrës së Dubravës në Dubravë-Istog” (vazhdon në vitin 2020).
- Punët Shtesë në Ekzekutimi i Punëve në Ndërtimin e “Kompleksit Memorial, Historik – Shtabi i ZOD të UÇK-së, Glllogjan- Deçan.

#### **5.1.3.4. Procedurat e projektimit:**

Ndërtimi i Shtatoreve LOT 1 - Ndërtimi ”Shtatores së Heroit Adem Jashari- Fushë Kosovë dhe LOT 2 - Ndërtimi ”Shtatores së Heroit Ahmet Krasniqi - Vushtrri- Ritender.

## 5.2. Divizioni i Burimeve njërzore

Në kuadër të këtij divizioni janë zhvilluar këto aktivitete:

- Menaxhimi i pushimeve vjetore dhe mjekësore;
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit, me ç'rast në vitin 2019 kanë qenë të lejuar me buxhet dymbëdhjetë (12) pozita të lira, prej këtyre janë zhvilluar nëntë (9) procedura të rekrutimit, të gjitha janë plotësuar. Ndërsa tri (3) pozita (ciceron) kanë mbetë të lira për arsye se në procedurën e rekrutimit nuk ka pasur kandidatë të cilët i kanë plotësuar kushtet.
- Realizimi i planit të trajnimeve.

### Tabela e Trajnimeve 2019

Tabela 4. Tabela e trajnimeve 2019

<b>Nr.</b>	<b>Nr. i punëtorëve të trajnuar</b>	<b>Fusha e Trajnimit</b>	<b>Ofruesi i trajnimit</b>
1.	1	Auditim i Brendshëm	IKAF, IKAP
2	1	Menaxhim i Përgjithshëm	IKAP
3.	3	Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore	IKAP
4.	2	Legjislacion	IKAP, ADA Consulting
5.	6	Buxhet dhe Financa	Thesari MFT
6.	2	Prokurim	KRPP, IKAP
7.	1	IT	BIT ACADEMY
8.	1	Arkivë	ADA Consulting

## **6. Përmirësimet dhe monitorimi i fushës së veprimit**

- Kemi instaluar programin e sistemit të furnizimit dhe mirëmbajtjes me flamuj dhe shtylla;
- Kemi bërë zgjerimin e rrjetit të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së komplekseve në krahasim me vitet paraprake;
- Kemi bërë monitorimin me video kamera të kompleksit "Adem Jashari";
- Kemi mbikqyrur secilën fazë të punimeve të projekteve;
- Kemi krijuar fan page-in dhe kemi bërë menaxhimi i Web faqes;
- Kemi inicuar krijimin e bazës së të dhënave për komplekset dhe memorialet (shih shtojcën 3).



## **7. PLANET QË PARASHIKOHEN PËR VITIN 2020**

Duke pasë parasysh organizimin e Agjencisë, planet që parashikohen të realizohen do të ndahen në bazë të departamenteve.

### **7.1. Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme**

- Realizimi i projekteve të paraparë me Ligjin e Buxhetit 2020; (Shtojca 2)
- Mirëmbajtja e kompleksve dhe memorialeve;
- Finalizimi i projekteve të bartura nga viti 2019;
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe Transfereve MFT dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Mjedisit MIM për shpronësimin e pronave ku gjenden komplekset dhe memorialet;
- Krijimi i strategjisë dhe fushëveprimit të agjencisë;
- Kërkesa për rritje të buxhetit dhe stafit;
- Mirëmbajtja e web faqes së AMKMK-së Komplexit Memorial “Adem Jashari”;
- Funkcionalizimi i procesit të të hyrave vetanake në K.M “Adem Jashari”, Prekaz.

### **7.2. Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim**

- Rritja e stafit profesional në këtë departament;
- Menaxhimi i projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2020 (Shtojca 2);
- Mbikqyrja e punimeve ndërtimore;
- Analizimi i projekteve;
- Projektimi i projekteve;

### **7.3. Divizioni i Prokurimit**

#### **7.3.1 Procedurat për furnizim**

- Furnizim me inventar për zyrat e AMKMK-së;
- Furnizim me kalendarë, kimika e material tjetër me llogo të AMKMK-së;
- Furnizim me pajisje të teknologjisë informative.

#### **7.3.2 Procedurat për shërbime**

- Mirëmbajtja e Komplexit Memorial "Adem Jashari " Prekaz – Skenderaj;
- Mirëmbajtja e Komplexit Memorial “27 Prilli” Meje- Gjakovë;
- Memoriali “Ibrahim Rugova” Prishtinë - Riprojektim;
- Projektimi - Ngritja e Monumentit Madhor në Gurin e Gradinës- Malet e Berishës;

- Projektimi - Konservimi dhe Restaurimi i Disa Objekteve të Luftës së UÇK-së dhe Objekteve ku janë kryer masakrat;
- Projektme të ndryshme për Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale, Varreza të Dëshmorëve dhe Martirëve etj;
- Mirëmbajtja e varrezave dhe lapidarëve në Komunën e Pejës dhe Istogut;
- Mirëmbajtja e varrezave dhe lapidarëve në Komunën e Skënderajt;
- Mirëmbajtja e K.M. "Baza e Parë e UÇK-së" në Lladovc-Podujevë;
- Mirëmbajtja e Memorialit "Zahir Pajaziti" Pestova në Vushtri;
- Mirëmbajtja e Komplekseve dhe memorialëve në Komunën e Drenasit;
- Mirëmbajtja e Projekteve të ndryshme për Intervenime Emergjente në;
- Komplekse Memoriale Varreza të Dëshmorëve dhe Martirëve etj.

### **7.3.3. Procedurat për ekzekutim të punimeve:**

- Konservimi i "Shtëpive të Rezistencës" në Kompleksin Memorial "Adem Jashari Prekaz – Skënderaj;
- Kompleksi Memorial "Beteja e Koshares" Koshare-Faza IV
- Konservimi i Shtabit në Kostërc dhe Ndërtimi i varrezave të Dëshmorëve Kosterc Skënderaj faza II
- Obelisku i të Rënëve në Demonstratat e Vitit 1981
- Lapidari i Dëshmorëve Irzniq- Deçan
- Kulla e Fehmi Lladrovci - Gllanasellë- Drenas;
- Ngritja e Shtatores së Veprimtarit Anton Çeta - Prishtinë - ndërtimi i bazamentit;
- Muzeu Kadri Zeka –Kamenicë;
- Lapidari i Dëshmorëve, Korroticë e Ulët – Drenas;
- Kompleksi Memorial "Masakra e Raçakut" Raçak - Shtime-Faza IV;
- Lapidari i Dëshmorëve -Hajdin Haliti dhe Sami Plakolli, Orllan- Podujevë;
- Lapidari i Dëshmorëve në Nekovc- Drenas;
- Memoriali masakra e Krushës së Madhe -Rahovec;
- Memoriali Masakra e Krushës së Vogël –Prizren
- Memoriali në Kamenicë, Istog;
- Ndërtimi i Memorialit, Orrobërdë- Istog;
- Rregullimi i Lapidarit në Kaliqan-Istog;
- Lapidari i Elfete Humolli, Lupq- Podujevë;
- Konservimi i Shtëpisë ku është kryer masakra në Poklek të Vjetër - Drenas;
- Lapidari i Nxënësve të vvarë, Shtedim- Podujevë;
- Lapidari "Hyzri Talla" Bregu i Diellit – Prishtinë
- Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale -Varreza të Dëshmorëve dhe Martirëve etj;

- Lapidari i Ymer Alushani, Komoran- Drenas;
- Lapidari në Zahaq, Pejë
- Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorëve Ramadan, Bashkim dhe Besim Muleta, Korroticë e Epërme- Drenas
- Ndërtimi i Memorialit Nivokaz –Gjakovë;
- Rregullimi i rrethojës së Varrezave të Dëshmorëve Ranzë- Shtime;
- Kompleksi Memorial “ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë- Malet e Berishës-Faza III
- Kompleksi Memorial “Shtabi I UÇK-së dhe Varrezat e Dëshmorëve”- Gllogjan Deçan-Faza II;
- Kompleksi Memorial 27 Prili Meje, Gjakovë-Faza IV;
- Lapidari i Maskrës së Burgut të Dubravës- Istog;
- Memoriali i Martirëve Studime -Vushtrri;
- Rregullimi i Varrezave të UÇK-së në Viti dhe derdhja në bronz e busteve Bajram dhe Gursel Sylejmani Sadovinë-Viti (faza II)
- K M. “Demë Ahmeti” Reqicë -Podujevë;
- K M. “I Ish Presidentit Rugova” Velani -Prishtinë;
- Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së në Gramaqel- Deçan;
- K M. i Dëshmorëve në Carrabreg i Epërm -Deçan;
- Konservimi dhe restaurimi i disa objekteve të luftës së UÇK-së dhe disa objekte ku janë kryer Masakrat;
- Ndërtimi i Shtatoreve të Dëshmorëve të Drenicës në periudha të ndryshme Skënderaj;
- K M. Shtabi dhe Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Shqiponjë-Gjakovë;
- Obelisku i Fëmijëve të vrarë - Aeroport –Sllatinë, Lipjan - Prishtinë;
- Bunker i Gjon Sereqit, Shipashnicë- Kamenicë;
- Rregullimi i Varrezave të dëshmorëve - Marec - Prishtinë;
- Rekonstruimi i Lapidarit në Hereq -Gjakovë;
- Monumenti për Batalionin e -I- të Brigadës 142 UÇK-së- Vushtrri;
- Renovimi i Lapidarëve dhe Varrezave në Komunën e Suharekës;
- Rregullimi i Parkut të Varrezat e Dëshmorëve Dyz –Podujevë;
- Rregullimi i Lapidarit të Dëshmorit Ahmet Pantina, Llozice- Malishevë;
- Memoriali i Rezistencës së Pollatës- Podujevë;
- Rregullimi i shtatores së Isa Kastriotit dhe renovimi i Lapidarëve -Kamenicë;
- Restaurimi i Lapidarit të Dëshmorit Abedin Bujupi Negroc – Drenas;
- Lapidari për Hoxhën Avdyll Krasniqi” Vojnik -Skënderaj.

#### 7.3.4. Procedurat e projektimit:

- Shtatorja e Doktor Hafir Shala- Drenas;
- Shtatorja e Xhavit Hazirit- Prishtinë;
- Ndërtimi i Shtatoreve të Dëshmorëve të Drenicës në Periudha të ndryshme Skënderaj;
- Ndërtimi i Shtatores së Isa Kastratit - Kamenicë.

#### 7.4 . Divizioni i Burimeve Njerzore

Aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2020 do të jenë:

- Menaxhimi i pushimeve vjetore dhe mjekësore;
- Implemetimi i planit të trajnimeve (shih tabelen nr. 5)
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës nevojat për punëtorë të rinj janë të domosdoshme, sidomos në Departamentin për Planifikim dhe Projekte të Komplekseve Memoriale.

Nevojat për punëtor të rinj dhe avancimet në AMKMK parashihen:

##### **Zyra e drejtorit të AMKMK-së**

- Udhëheqës i Divizionit për Auditim - një (1)
- Zyrtar i Personelit - një (1).

##### **Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve**

- Arkitekt - dy (2);
- Inxhinier i Ndërtimtarisë - dy (2);
- Ciceron - pesë (5).

Trajnimet për vitin 2020 janë të harmonizuara me planin vjetor të trajnimeve të IKAP-it.

Tabela 5. Plani vjetor i trajnimit i nënpunësit civil për periudhën Janar – Dhjetor 2020

<b>Nr.</b>	<b>Nr. i punëtorëve të trajnuar</b>	<b>Fusha e Trajnimit</b>	<b>Ofruesi i trajnimit</b>
1.	4	<b>Menaxhim i Përgjithshëm</b>	
2.	3	<b>Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore</b>	
3.	2	<b>Legjislacion</b>	

4.	2	<b>Buxhet dhe Financa</b>	
5.	2	<b>Prokurim</b>	
6.	2	<b>IT dhe Logjistikë</b>	
7.	2	<b>Arkitekturë dhe Ndërtimtari</b>	
8.	2	<b>Arkivë</b>	
9.	6	<b>Trajnime për BE</b>	

## 8. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit ( Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit)

Agjencia ka linjë të pavarur buxhetore duke iu përmbajtur Ligjit për Shërbimin Civil dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Sfidat e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale kryesisht kanë të bëjnë me fushëveprimin dhe misionin e kësaj agjencie. Sfida kryesore gjatë vitit të kaluar të cilat vazhdojnë edhe këtë vit janë:

- Problemi i shpronësimit, ku shumë projekte kanë dështuar ose kanë ngecur shkaku i kësaj problematike (shih tabelën 6).
- Bazuar në numrin e madh të komplekseve dhe memorialeve që presin për t'u ndërtuar ose për t'u mirëmbajtur kemi mungesë të buxhetit.
- Sfidë tjetër është edhe mungesa e stafit profesional sidomos në Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve. Pasiqë fushëveprimi i Agjencisë është kryesisht në ndërtim, rindërtim, menaxhim dhe promovim të komplekseve dhe memorialeve, kemi mungesë të personelit profesional: arkitekt dhe inxhinier të ndërtimit dhe ciceronë, ku dihet se në Kompleksin Memorial Adem Jashari janë vetëm dy ciceronë, të cilët nuk arrijnë as përafërsisht ti mbulojnë kërkesat e vizitorëve).
- Një tjetër sfidë ka qenë edhe krijimi i strategjisë dhe planit të veprimit të Agjencisë dhe krijimi i sistemit GIS për komplekset dhe memorialet, kjo pasi që viteve paraprake nuk na janë ndarë mjete.
- Si sfiduese ka qenë edhe mungesa e buxhetit në linjën paga dhe mëditje për punëtorët të cilët dalin në terren.

Tabela 6. Komplekset memoriale. pronat e të cilëve kanë probleme të shpronësimit

Kompleksi Memorial	Zona Kadastrale	Komuna
“Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës”, Shtëpia dhe Bunkeri i “Radio Kosova e Lirë;	Berishë	Malishevë
“Masakra e Likoshanit”	Likoshan	Drenas
“Dëshmorët e Kombit”	Vrellë	Istog
“Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së- Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës”/ shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, spitalet e UÇK-së, Qendra protokollare;	Zona Kadastrale Divjake	Lipjan
shtabi i Komandant Fatmir Limajt, Pushimorja e Fëmijëve dhe Fshati i	Kleçkë	Lipjan

UÇK-së		
Shtëpia e Delegacionit të Rambujesë - Qeveria e Përkohshme në Novosellë	Tërpezë	Malishevë
Mulliri i UÇK-së	Shalë (ish Sadllari)	Lipjan
Shtabi i Komandant Kumanova.	Luzhnicë	Suharekë

Pa u kryer shpronësimi, nuk ka mundësi të vazhdojmë me punimet e mëtejme në ngritjen e këtyre Komplekseve Memoriale. Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Shpronësimit për sigurimin e mjeteve, ne si institucion kemi dërguar Elaboratet në Departamentin e shpronësimit në MMPH, dhe presim që të na realizohen këto kërkesa, përndryshe shumë projekte do na mbesin pa u realizuar.

Prandaj, për t'i realizuar tërë objektivat duhet të bëhet ndarja e buxhetit të mjaftueshëm, sipas parashikimeve tona, si:

- Rritja e numrit të punëtorëve të AMKMK-së: punësimi i stafit në administratë, punëtorëve profesional (arkitekt, ndërtimtarë) dhe ciceronëve;
- Rritja e buxhetit për projekte kapitale;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime si dhe
- Është e domosdoshme rritja e buxhetit për shpenzime komunale me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrimeve, sepse ndarja e mjeteve buxhetore në këtë linjë nuk i mbulon shpenzimet për të gjitha Komplekset dhe Memorialet, andaj kërkojmë që për kryerjen e këtyre obligimeve pa ndërlikime të ndahen mjete të mjaftueshme financiare.

AMKMK vitin e kaluar ka pasur një rritje të vogël të buxhetit dhe është plotësuar stafi me disa zyrtarë të ri, megjithëse është i pamjaftueshëm.

Nuk kemi pasur deri më tani ndryshim, plotësim të Ligjit aktual.

Rekomandojmë se për mbarëvajtjen e Agjencisë duhet të na trajtohen rekomandimet e lartëshënuara, nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural Infrastrukturë dhe Mjedis, dhe Komisioni për Financa dhe Transfere në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe në anën tjetër edhe nga Qeveria dhe Ministria e Financave, për realizimin e objektivave të parashikuara nga Agjencia.


AMKMK do të përmbushë në mënyrë efikase dhe me integritet detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i përcakton Ligji Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Ligji Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

## 9. Raporti Financiar

Buxheti fillestar për AMKMK-në për vitin 2019 ishte: 6,933,973.00 €; Buxheti final: 3,851,323.00€.

Tabela 7. Buxheti

Kategoritë	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet 2019	%
Paga e mëditje	174,102.00	120,224.00	120,224.00	100
Mallra e shërbime	74,871.00	74,871.00	73,045.00	97.56
Shpenzimet komunale	55,000.00	55,000.00	31,741.00	57.71
Investimet kapitale	6,630,000.00	3,601,228.00	3,332,766.00	92.54
<b>Totali</b>	<b>6,933,973.00</b>	<b>3,851,323.00</b>	<b>3,557,775.00</b>	<b>92.37</b>





\* Me vendime të Qeverisë dt. 05.11.2019 dhe 17.12.2019 me nr.02/113 dhe 03/115 AMKMK-së, i janë marr këto mjete për kursime:

Nga fondit 10, të shpenzimet kapitale janë marr këto mjete:

1. Projekti 14645 K.M Masakra e Reçakut: 19,599.00€.
2. Projekti 14647 K.M Varrezat e Dëshmoreve: 21,799.00€.
3. Projekti 15806 K.M Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse, hapja e shtigjeve, Gorozhup: 10,312.00€.
4. Projekti 15808 Ngritja e shtatores Anton Cetta: 10,000.00€.
5. Projekti 18057 Kulla e heroit Fehmi Lladrovci: 10,000.00€.
6. Projekti 18098 Rregullimi i lapidarit të dëshmorëve: 4,878.00€.
7. Projekti 18272 Lapidari i Zahir Pajazitit, Pestovë: 1,331.00€.
8. Projekti 18295 Mirëmbajtja e memorialeve dhe varrezave: 10,000.00€.
9. Projekti 13851 K.M Adem Jashari, Prekaz: 922,009.10€.
10. Projekti 13280 Mirëmbajtja e K.M Adem Jashari, Prekaz: 10,051.00€.
11. Projekti 14651 Maskara e Likoshanit, Likoshan: 6,660.00€.
12. Projekti 18296 Rregullimi i varrezave të dëshmorëve të UÇK-së: 2,132.50€.

Nga fondit 24, të shpenzimet kapitale janë marr këto mjete:

1. Projekti 13851 K.M "Adem Jashari" Prekaz: 2,000,000.00€

Nga kategoria paga e mëditje janë marrë mjetet për kursim gjithsejt: 53,877.94€

**Këtij Raporti Vjetor të Punës do t'ia bashkëngjesim edhe Raportin Vjetor Financiar 2019 të AMKMK-së.**

## 10. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vleresimi i rrezikut
Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që projektet hartohen bazuar në përmbushjen e kërkesave për arritjen e qëllimit përfundimtar. Poashtu të siguroj që çdo ndryshim i projektit të arsyetohet me shkrim.	AMKMK do të marr parasysh rekomandimin e ZKA që të mos përsëriten më. Por, AMKMK ka vendosur që të mos realizojë pozicionin e tetë të projektit "Ekzekutimi i punëve në riparimin e dëmtimin dhe vendosja e pllakës përkujtimore në Varrezat e dëshmorëve Kleçkë", për shkak të disa gabimeve teknike gjatë projektimit. Me këtë vendim është pajtuar edhe operatori ekonomik.	Janar 2019	I Zbatuar	Gabimet gjatë projektimit dhe mangësitë në menaxhimin e kontratave rrisin rrezikun që kontratat nuk janë duke u realizuar në pajtim me kushtet dhe specifikat e parapara për arritjen e qëllimit përfundimtar.
Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që të gjitha projektet të realizohen sipas tabelës 3.2 të buxhetit.	Titulli i projektit është ndryshuar për arsye se Kuvendi i Kosovës ka aprovuar projektin me titullin Mirëmbajtja dhe rregullimi i sheshit Adem Jashari, Malishevë, mirëpo AMKMK gjatë konsultimit dhe bashkëpunimit me komunën përkatëse ka rezultuar se projekti ka të bëjë me Ndërtimin e Lapidarit të varrezave të dëshmorëve në Malishevë.	Janar 2019	I Zbatuar	Shpenzimet të buxhetit për projektet të cilat nuk janë të aprovuara sipas ligjit të buxhetit vështirësojnë vendimarrjen në lidhje me investimet kapitale, si dhe shkakton pasqyrim të pasaktë të projekteve të realizuara brenda të kategorisë së investimeve kapitale.

<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrollë me rastin e ndarjes së detyrave në mënyrë që kjo të bëhet në pajtim me kërkesat e udhëzuesit operativ të prokurimit për të parandaluar rastet e tilla.</p>	<p>AMKMK gjatë vitit 2018 ka pasur gjithsej 12 punëtor ku tre prej tyre punojnë në Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz. Për shkak të mungesës së stafit një zyrtari i janë caktuar disa detyra. Por me buxhetin e vitit 2019 na janë lejuar 24 punëtor dhe do të bëhet shpërndarja e detyrave.</p>	<p>Janar - Dhjetor 2019</p>	<p>I Zbatuar</p>	<p>Kryerja e më shumë detyrave nga I njëjti zyrtar, që nga iniciimi I procedurave të prokurimit e deri te pranimi I punëve të kryera jashtë fushës së përgjegjesisë së tij, përveç që është në kundërshtim me parimet e ndarjes së detyrave e rrezikon edhe objektivitetin gjatë gjithë procesit të prokurimit. Krejtë kjo mund të ndikoj edhe në përzgjedhjen e operatorit fitues në mënyrë jo objektive.</p>
<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrë veprimet e nevojshme për të aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Më pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e Agjencisë të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.</p>	<p>AMKMK në qershor të këtij viti (2019), ka plotësuar pozitën Zyrtar i Pasurisë, dhe kemi dërguar kërkesn në MAP/ASHI për trajnim dhe çertifikim për E-pasuria.</p>	<p>Qershor 2019</p>	<p>I Zbatuar</p>	<p>Mos funksionalizimi I sistemit E-pasuria, vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përlogaritjes manuale të zhvlerësimit, po ashtu, kjo mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë.</p>

## 9. Shtojcat

Në AMKMK janë nxjerrë Vendime të rëndësishme si:

- Vendime për Formimin e Komisioneve të ndryshme për hapjen dhe vlerësimin e Ofertave -AMKMK;
- Vendim për caktimin e menaxherëve për mbikëqyrjen e projekteve kapitale;
- Vendime për caktimin e ekspertëve vendor dhe të jashtëm për përcjelljen e punës në hartimin e projekteve ideore, kryesore në konservimin dhe restaurimin objekteve memoriale të ndryshme;
- Vendim për Komisione për rekrutimin e Shërbyesve Civil;
- Vendim për Komisionin Konteste dhe Ankesa dhe Komisionin për Shkelje Disiplinore;
- Vendime për pranimin teknik të projekteve kapitale të cilat i ka investuar AMKMK;
- Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit;
- Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizuesit dhe të drejtat e tyre;
- AMKMK nuk ka Bord dhe nuk është Autoritet Rregullativ nuk lëshon dhe revokon Licenca.

## Shtojca Nr. 1. Asetet që posedon AMKMK-ja

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndrys him i vlerës	Amortizim	Shitje	Vlera në libër
201400000007377	NDËRTIMI I GYPIT PËR FURNIZIM	31400	UJESJELLE SI	795,114.95	0.00	159,022.98	0.00	636,091.97
201400000007393	KRIJIMI I ËEB-FAQES SË AMKMK-	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	6,850.00	0.00	3,596.25	0.00	3,253.75
201400000007610	DEFINIMI I KUFIRIT TË Z.V K.M	31900	KAPITAL TJETER	39,499.74	0.00	20,737.35	0.00	18,762.39
201400000007623	MBIKQYRJA E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT	31400	UJËSJELLË SI	9,780.28	0.00	1,956.05	0.00	7,824.23
201400000008145	HARTIMI I PLANIT TË MENAXH. K	31900	KAPITAL TJETËR	44,900.00	0.00	22,450.00	0.00	22,450.00
8743	NDËRTIMI I RRUGËS	31200	NDËRTIMI I RRUGËVE	9,870.56	0.00	2,015.25	0.00	7,855.31
8903	HARTIMI I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	9,790.00	0.00	3,997.58	0.00	5,792.42
8906	MATJET GJEOMEKANIKE	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	9,893.00	0.00	4,122.08	0.00	5,770.92
9203	PLOTËSIMI I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	9,569.60	0.00	4,067.08	0.00	5,502.52
9208	KANALIZIMIT ATMOSFERIK	31250	KANALIZIMI	9,962.00	0.00	1,593.92	0.00	8,368.08
9211	HARTIMI I TERMAVE TË REFERENCËS	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	9,490.00	0.00	4,112.33	0.00	5,377.67
9215	ELABORATI I SHPRONËSIMIT	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	9,789.00	0.00	4,486.62	0.00	5,302.38
10141	MBIKËQYRJA E PUNIMEVE - PENUHË	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	9,800.00	0.00	4,001.67	0.00	5,798.33
10146	MBIKËQYRJA E PUNIMEVE - MARINË	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH	9,689.00	0.00	3,875.60	0.00	5,813.40

10147	MBIKËQYRJA E PUNIMEVE - KOSHARE	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	9,950.00	0.00	3,980.00	0.00	5,970.00
10290	PUNËT SHITESË-MARINË	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	31,329.58	0.00	12,531.84	0.00	18,797.74
10309	SANIMI I DËMEVE-PENUHË	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSH ME	30,967.74	0.00	12,387.09	0.00	18,580.65
10669	HART. I PROJEKTIT TË KONZERVIMIT	31900	KAPITAL TJETËR	491,964.00	0.00	221,383.80	0.00	270,580.20
13421	VETURË KIA SPORTAGE	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	10,470.95	0.00	9,519.05
13424	VETURË KIA SPORTAGE	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	10,470.95	0.00	9,519.05
15584	EKZE. I PUNIMEVE K.M-MARINË	31900	KAPITAL TJETËR	313,032.15	0.00	106,952.66	0.00	206,079.49
15590	PUNËT SHITESË-KOSHARE	31900	KAPITAL TJETËR	131,222.23	0.00	48,114.81	0.00	83,107.42
15592	PUNËT SHITESË-PENUHË	31900	KAPITAL TJETËR	29,310.38	0.00	10,747.15	0.00	18,563.23
15599	EKZEKUTIMI I PUNËVE-PENUHË	31900	KAPITAL TJETËR	301,144.06	0.00	110,419.49	0.00	190,724.57
20316	PUNËT SHITESË-KAÇANOLL	31900	KAPITAL TJETËR	6,687.80	0.00	2,006.34	0.00	4,681.46
20522	BAZAMENTI-HYRË EMINI-FERIZAJ	31900	KAPITAL TJETËR	8,061.00	0.00	2,418.30	0.00	5,642.70
20533	BAZAMENTI-ËILLIAM ËALKER-RAÇAK	31900	KAPITAL TJETËR	69,611.70	0.00	20,883.51	0.00	48,728.19
20541	PUNË SHITESË-BAZAMENTI RAÇAK	31900	KAPITAL TJETËR	6,780.50	0.00	2,034.15	0.00	4,746.35
20582	SHTATORJA "HYRË EMINI"-FERIZAJ	31900	KAPITAL TJETËR	49,500.00	0.00	14,850.00	0.00	34,650.00
20591	SHTATORJA "ËILLIAM ËALKER"	31900	KAPITAL TJETËR	98,892.96	0.00	29,667.90	0.00	69,225.06
20637	DRENAZHIMI I VARREZAVE-KOSHARE	31250	KANALIZIMI	33,499.30	0.00	4,019.91	0.00	29,479.39
25227	KANALIZIMI-K.M-RAÇAK	31250	KANALIZIMI	6,019.29	0.00	541.73	0.00	5,477.56
25228	PUNËT SHITESË-K.M-RAÇAK	31900	KAPITAL TJETËR	8,609.04	0.00	1,937.03	0.00	6,672.01
25711	K.M."BETEJA E KOSHARES"-FAZA 2	31900	KAPITAL TJETËR	1,348,068.21	0.00	337,017.05	0.00	1,011,051.16

25714	PUNË SHITESË-FAZA IV-K.M-MARINË	31900	KAPITAL TJETËR	36,750.00	0.00	9,493.75	0.00	27,256.25
25935	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	36,067.00	0.00	0.00	0.00	36,067.00
25973	SHPRONËSIMI-KLEÇKË-DIVJAKË	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSHME	15,500.00	0.00	3,875.00	0.00	11,625.00
26887	PUNË SHITESË-K.M-LIKOSHAN	31900	KAPITAL TJETËR	19,447.88	0.00	4,213.71	0.00	15,234.17
26925	PUNË SHITESË-K.M-MEJE, GJAKOVË	31900	KAPITAL TJETËR	35,916.65	0.00	8,380.56	0.00	27,536.09
28224	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	97,162.80	0.00	0.00	0.00	97,162.80
28235	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	21,404.00	0.00	0.00	0.00	21,404.00
28260	K.M "MASAKRA E RAÇAKUT"	31900	KAPITAL TJETËR	109,002.00	0.00	22,708.75	0.00	86,293.25
28263	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	55,277.00	0.00	0.00	0.00	55,277.00
28269	PUNIMET FAZA IV K.M-MARINË	31900	KAPITAL TJETËR	374,964.93	0.00	78,117.69	0.00	296,847.24
29034	RISHIKIMI I PROJEKT, KONSERVIMIT	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSHME	50,000.00	0.00	10,000.00	0.00	40,000.00
29276	K.M"DEMË AHMETI"-PODUJEVË	32500	INVESTIME T NË VIJIM	170,000.00	0.00	0.00	0.00	170,000.00
29472	K.M"DËSHMORËT E UÇK-SË"-PENUHË	31900	KAPITAL TJETËR	629,500.97	0.00	125,900.19	0.00	503,600.78
29489	PUNË SHITESË-K.M-PENUHË	31900	KAPITAL TJETËR	60,172.01	0.00	15,043.00	0.00	45,129.01
29507	K.M "MASAKRA E LIKOSHANIT"	31900	KAPITAL TJETËR	198,999.01	0.00	39,799.80	0.00	159,199.21
31857	RINDËRTIMI I K.M KAÇANOLL	31900	KAPITAL TJETËR	93,300.00	0.00	27,990.00	0.00	65,310.00
32875	NDËRTIMI I SHTATOREVE-PODUJEVË	31900	KAPITAL TJETËR	248,000.00	0.00	45,466.67	0.00	202,533.33
32880	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	121,804.20	0.00	0.00	0.00	121,804.20
33745	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	118,400.00	0.00	0.00	0.00	118,400.00

33750	PUNË SHITESË- KLEÇKË & DIVJAKË	31900	KAPITAL TJETËR	48.690.22	0.00	7,709.28	0.00	40,980.94
33751	K.M"DEMË AHMETI"- PODUJEVË	32500	INVESTIME T NË VIJIM	100,000.00	0.00	0.00	0.00	100,000.00
33752	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	81,520.00	0.00	0.00	0.00	81,520.00
33905	K.M-MASAKRA LIKOSHANIT-FAZA II	31900	KAPITAL TJETËR	98,157.70	0.00	15,541.64	0.00	82,616.06
35667	RREGULLIMI I VARREZAVE - DYZ	31900	KAPITAL TJETËR	87,855.76	0.00	12,446.24	0.00	75,409.52
35668	SANIMI I DËMËVE NË LIKOVÇ	31900	KAPITAL TJETËR	3,459.50	0.00	490.10	0.00	2,969.40
35671	VAZHDIMI I PROJEKTIT- NEGROVÇ	31900	KAPITAL TJETËR	9,197.53	0.00	1,302.98	0.00	7,894.55
35732	K.M"BETEJA E KOSHARES"-FAZA 3	32500	INVESTIME T NË VIJIM	30,313.00	0.00	0.00	0.00	30,313.00
